

**LIGJI NR. 08/L-231**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE REPUBLIKËS SË SLLOVENISË PËR NDIHMË TË NDËRSJELLË JURIDIKE NË ÇËSHTJE PENALE**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE REPUBLIKËS SË SLLOVENISË PËR NDIHMË TË NDËRSJELLË JURIDIKE NË ÇËSHTJE PENALE**

**Neni 1  
Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim të ratifikojë Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Sllovenisë për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështje Penale, të nënshkruar nga Ministri i Drejtësisë të të dy vendeve më datë 28.10.2016 në Slloveni.

**Neni 2  
Fushëveprimi**

Ky ligj vlen për të gjitha organet e administratës shtetërore dhe organet gjyqësore në Kosovë që janë përgjegjëse për bashkëpunim juridik ndërkombëtar.

**Neni 3  
Dokumentet e bashkëngjitura**

Në shtojcën e këtij ligji është bashkëngjitur teksti i Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Sllovenisë për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështje Penale.

**Neni 4  
Hyrja në fuqi**

Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 08/L-231  
8 qershor 2023**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-114/2023, datë 22.06.2023 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu**

\*Ligji nr. 08/L-231 "Për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Sllovenisë për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështje Penale", bashkëngjitur me marrëveshje janë publikuar në web faqen e Gazetës Zyrtare (gzk.rks-gov.net)

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET**  
**REPUBLIKËS SË KOSOVËS**  
**DHE**  
**REPUBLIKËS SË SLLOVENISË**  
**PËR NDIHMË TË NDËRSJELLË JURIDIKE NË ÇËSHTJE PENALE**

Republika e Kosovës dhe Republika e Sllovenisë (më tej: Palët);

në dëshirën e tyre për zhvillimin e mëtutjeshëm dhe fuqizimin e marrëdhënieve bilaterale në fushën e ndihmës së ndërsjellë juridike në çështjet penale mes dy vendeve;

Kanë rënë dakord si më poshtë:

**KAPITULLI NJË**  
**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Ofrimi i ndihmës juridike**  
**Neni 1**

- (1) Palët i ofrojnë njëra tjetrës ndihmë të ndërsjellë juridike në çështje penale, sipas kushteve dhe brenda fushëveprimit të parashikuar në këtë Marrëveshje.
- (2) Në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet gjyqësore të Palëve ofrojnë ndihmë juridike për autoritetet gjyqësore dhe autoritetet tjera, të cilat, sipas legjislacionit të Palës, janë kompetente për t'u marrë me çështjet penale.

**Fushëveprimi i ndihmës juridike**  
**Neni 2**

- (1) Palët, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, marrin përsipër t'i ofrojnë njëra-tjetrës ndihmën më të gjerë të ndërsjellë juridike në çështjet penale.
- (2) Ndihma juridike në çështjet penale përfshin, në mënyrë të veçantë:
  1. ndërmarrjen e masave procedurale, të tilla si fletëthirrjet dhe shërbimi i dokumenteve, dëgjimin e të pandehurit, marrjen në pyetje të dëshmitarëve, të dëshmitarëve ekspertë dhe të personave të tjerë, hetimin në vendin e ngjarjes, kontrollin e objekteve dhe personave, sekuestrimin e objekteve;
  2. zbatimin e masave të veçanta të tilla si përgjimi dhe regjistrimi i bisedave telefonike, bisedave ose komunikimeve të tjera dhe regjistrimeve optike të personave, dërgesat e

kontrolluara, transaksionet e simuluar, angazhimi i hetuesve të fshehtë, kontrollet e një sistemi kompjuterik apo pjese të tij dhe të dhënave që i përmban ai, si dhe përpunimi i të dhënave të tilla;

3. shkëmbimin e njoftimeve dhe dërgimin e dokumenteve dhe objekteve që lidhen me procedurat penale, shkëmbimin spontan të informatave, seancat dëgjimore me anë të lidhjeve për audio dhe video konferenca, formimin e njërive të përbashkëta të hetimeve;
4. dorëzimin e përkohshëm të personit të privuar nga liria, në cilësinë e dëshmitarit ose dëshmitarit ekspert, apo për ballafaqim para autoritetit kompetent të Shtetit kërkues;
5. ngrirjen dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi dhe sendeve që lidhen me veprat penale;
6. transferimin e aktgjyqimeve penale dhe informatave të marra nga dosjet gjyqësore;
7. shkëmbimin e informatave mbi legjislacionin;
8. transferimin e procedurave penale;
9. çdo formë tjetër të ndihmës që nuk është në kundërshtim me ligjin e Shtetit të kërkuar.

#### Kanalet e komunikimit

##### Neni 3

- (1) Në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente të Palëve komunikojnë me shkrim nëpërmjet autoriteteve qendrore - Republika e Kosovës përmes Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës dhe Republika e Sllovenisë përmes Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Sllovenisë.
- (2) Kanali diplomatik nuk përjashtohet nëse ka shkaqe të arsyeshme për të.
- (3) Në raste urgjente, autoritetet gjyqësore dhe autoritetet tjera kompetente të Palëve mund gjithashtu të komunikojnë nëpërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (INTERPOL). Në të njëjtën kohë kërkesa origjinale transmetohet nëpërmjet autoritetit qendror të Shtetit kërkues për autoritetin qendror të Shtetit të kërkuar.

#### Gjuha dhe legalizimi

##### Neni 4

- (1) Kërkesa për ndihmë juridike dhe dokumentet mbështetëse shoqërohen nga një përkthim në gjuhën e Shtetit të kërkuar, që është gjuha shqipe, serbe ose angleze për Republikën e Kosovës dhe gjuha sllovene ose angleze për Republikën e Sllovenisë.
- (2) Legalizimi i dokumenteve të referuara në paragrafin 1 të këtij Neni nuk është i nevojshëm.
- (3) Përgjigja ndaj një kërkesë me dokumente të bashkangjitura (të dhëna, vendime të gjykatave dhe të tjera), dorëzohen në gjuhën e Shtetit të Kërkuar.
- (4) Dokumentet që duhet t'u shërbehen personave në Shtetin e kërkuar, dorëzohen në gjuhën zyrtare të Shtetit kërkues, me përkthim të bashkangjitur në gjuhën e Shtetit të kërkuar.
- (5) Nëse përkthimi, në rastin e referuar në paragrafin 4 të këtij Neni, nuk është bashkangjitur, shërbimi bëhet vetëm nëse marrësi pranon dokumentin vullnetarisht.

#### Forma dhe përmbajtja e kërkesës

##### Neni 5

- (1) Kërkesa për ndihmë juridike sipas kësaj Marrëveshjeje, dorëzohet në formë të shkruar.
- (2) Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, kërkesa për ndihmë juridike përmban:
  1. emrin e autoritetit të Shtetit kërkues nga i cili bëhet kërkesa;

2. emrin e autoritetit të cilit i është adresuar kërkesa, dhe nëse nuk dihet emri i saktë, emërtimin "autoritetit kompetent", me emrin e Shtetit të kërkuar;
  3. numrin e dosjes dhe një përshkrim konciz të rastit për të cilin kërkohet ndihma juridike, titullin ligjor të veprës penale dhe tekstin e dispozitave të ligjit penal të Shtetit kërkues;
  4. objektin e kërkesës për ndihmë juridike, dhe, kur është e nevojshme, pyetjet që duhet t'i bëhen personit për të cilin kërkohet seanca dëgjimore;
  5. të dhëna të tjera të parashikuara sipas kësaj Marrëveshjeje për ndonjë lloj të veçantë të ndihmës juridike.
- (3) Kërkesat dhe dokumentet e bashkangjitura të dërguara nga autoritetet gjyqësore ose autoritete të tjera të Palëve nënshkruhen dhe shënohen me vulën e autoritetit gjyqësor apo të autoriteteve tjera nga të cilat ato burojnë.
- (4) Kërkesa për kontrollim të personave ose objekteve apo edhe për konfiskim ose sekuestrim të sendeve ose të të ardhurave nga krimi, shoqërohet nga origjinali ose kopja e vërtetuar e vendimit në të cilin bazohet kërkesa e caktuar.
- (5) Objektet dhe origjinalet e dokumenteve që janë dorëzuar për ekzekutimin e kërkesës, i kthehen nga ana e Shtetit kërkues Shtetit të kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, përveç kur Shteti i kërkuar nuk kërkon që t'i kthehen ato.
- (6) Autoriteti kompetent i Shtetit të kërkuar mund të kërkojë informata dhe dokumente shtesë që i konsideron si të nevojshme për ekzekutimin e kërkesës.

#### Veprimi në bazë të kërkesës Neni 6

- (1) Veprimi në bazë të kërkesës kryhet pa vonesë dhe në përputhje me ligjin e Shtetit të kërkuar.
- (2) Pavarësisht dispozitave të paragrafit 1 të këtij Neni, me kërkesë të autoritetit kompetent të Shtetit kërkues, autoriteti i kërkuar procedon sipas mënyrën së treguar në kërkesë, nëse ajo nuk është në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik të Shtetit të kërkuar.
- (3) Nëse autoriteti i kërkuar nuk është në gjendje të veprojë në përputhje me kërkesën, ai për këtë njofton menjëherë autoritetin e Shtetit kërkues dhe kthen dokumentet e dorëzuara duke deklaruar arsyet se pse nuk ka mundur të veprojë në bazë të kërkesës.

#### Refuzimi i ndihmës juridike Neni 7

Shteti i kërkuar refuzon ofrimin e ndihmës juridike nëse:

1. nuk përmbushen kushtet e parashikuara nga kjo Marrëveshje;
2. kërkesa ka të bëjë me një veprë penale e cila sipas mendimit të Shtetit të kërkuar është e një natyre politike ose ushtarake;
3. konsideron se veprimi në bazë të kërkesës ka të ngjarë të cenojë sovranitetin ose sigurinë e tij, ose do të ishte në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik të tij.

**Shtyrja e ekzekutimit të një kërkesë**  
**Neni 8**

- (1) Shteti i kërkuar mund ta shtyjë ekzekutimin e kërkesës, nëse kjo është e nevojshme për kryerjen e duhur të procedurave penale të cilat janë në pritje për t'u zgjidhur pranë autoriteteve gjyqësore vendore dhe të cilat lidhen me kërkesën e parashtruar.
- (2) Shteti i kërkuar informon Shtetin kërkuar për arsyet e shtyrjes së ekzekutimit të kërkesës të referuar në paragrafin 1 të këtij Neni.

**Shpenzimet e ndihmës juridike**  
**Neni 9**

- (1) Secila palë mbulon shpenzimet e ofrimit të ndihmës juridike që shkaktohen në territorin e vet, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje.
- (2) Palët nuk kërkojnë kompensimin e shpenzimeve për aktivitetet e kryera në bazë të kërkesave, përveç për:
  1. tarifatat për vlerësimet e dëshmitarëve ekspertë dhe për shpenzime tjera të bëra në vlerësimet e dëshmitarëve ekspertë,
  2. shpenzimet për dorëzimin e përkohshëm të personit të privuar nga liria në territorin e Shtetit të Kërkuar tek territori i Shtetit Kërkuar me qëllim të një seance dëgjimore, në cilësinë e dëshmitarit ose dëshmitarit ekspert, apo të ballafaqimit.
- (3) Vlerësimet e dëshmitarëve ekspertë mund të kushtëzohen me depozitimin paraprak të një paradhënie në gjykatën e kërkuar.
- (4) Një dëshmitar apo dëshmitar ekspert që i përgjigjet fletëthirrjes së gjykatës së Shtetit Kërkuar ka të drejtë në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe akomodimit, në përputhje me rregulloret e Shtetit Kërkuar.
- (5) Fletëthirrja duhet të specifikojë se cilat tarifa u përkasin personave të referuar në paragrafin 4 të këtij Neni, si dhe me kërkesën e tyre, u jepet një paradhënie për t'i mbuluar shpenzimet e tyre.

**Prania gjatë veprimeve të ndihmës juridike**  
**Neni 10**

- (1) Me kërkesën e tij të veçantë, Shteti Kërkuar informohet nga Shteti i Kërkuar për vendin dhe kohën e ekzekutimit të kërkesës.
- (2) Përfaqësuesit e autoriteteve kompetente gjyqësore të Shtetit kërkuar dhe personat e përfshirë në procedurë penale, si dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë, mund të jenë të pranishëm gjatë marrjes së veprimit të caktuar të ndihmës juridike, me pëlqimin e autoritetit kompetent gjyqësor të Shtetit të Kërkuar. Këta persona gëzojnë mbrojtjen e parashikuar në Nenin 15 të kësaj Marrëveshjeje.

**Mbrojtja dhe transmetimi i të dhënave personale**  
**Neni 11**

- (1) Shteti kërkuar mund të përdorë të dhënat personale të transmetuara në përputhje me këtë Marrëveshje, vetëm për:
  1. qëllime të zbatimit efektiv të procedurave penale, për të cilat vlen kjo Marrëveshje;
  2. procedura të tjera gjyqësore ose të kundërvajtjes të lidhura drejtpërsëdrejti me procedurën penale të referuar në pikën 1 të këtij paragrafi;
  3. parandalimin e kanosjes së drejtpërdrejtë dhe serioze për sigurinë publike;

4. qëllime të tjera që nuk janë në kundërshtim me pikat 1, 2 dhe 3 të paragrafit të parë të këtij Neni, por vetëm me pëlqimin paraprak të shtetit që ofron të dhënat, përveç kur Shteti Pranues ka marrë pëlqimin e personit me të cilin kanë të bëjnë të dhënat.
- (2) Secila Palë mund të refuzojë transmetimin e të dhënave personale të fituara si rezultat i ekzekutimit të kërkesës së dorëzuar në përputhje me këtë Marrëveshje me kusht që:
1. të dhënat e tilla i nënshtrohen mbrojtjes në bazë të legjislacionit vendor; ose
  2. pala së cilës do t'i transferohen këto të dhëna dështon në sigurimin e mbrojtjes së individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale në masën e përcaktuar me traktatet përkatëse ndërkombëtare, me përjashtim të rasteve kur kjo Palë ka marrë të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar mbrojtjen e të dhënave personale siç kërkohet nga Pala tjetër.
- (3) Pala e cila ka transmetuar të dhënat personale të fituara si rezultat i ekzekutimit të kërkesës së dorëzuar në përputhje me këtë Marrëveshje mund të kërkojë nga Shteti pranues informata mbi përdorimin e këtyre të dhënave.
- (4) Ky Nen vlen edhe për të dhënat personale që nuk transmetohen por fitohen në ndonjë mënyrë tjetër në përputhje me këtë Marrëveshje.
- (5) Transmetimi dhe përpunimi i të dhënave personale të ndjeshme (të dhënat personale që zbulojnë origjinën racore ose etnike, opinionet politike, fetare a filozofike, anëtarësinë në sindikata, të dhënat gjenetike apo biometrike të përpunuara apo të papërpunuara që mundësojnë identifikimin unik të personave dhe të dhënat në lidhje me shëndetin apo jetën seksuale, dosjet penale dhe të kundërvajtjeve) lejohen vetëm në një mënyrë të tillë që Pala që transmeton të dhënat, tregon domosdoshmërinë e mbrojtjes shtesë të këtyre të dhënave duke penguar personat ose autoritetet e paautorizuara nga qasja në to, ose nga përpunimi i paligjshëm. Shteti pranues merr parasysh këtë kufizim.
- (6) Të drejtat e individëve në lidhje me saktësinë, përditësimet dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave ushtrohen sipas legjislacionit vendor të Shtetit pranues.
- (7) Në kërkesën e tij për transmetimin e të dhënave personale, Shteti pranues gjithmonë duhet të deklarojë informacionin relevant të identifikimit të cilin e posedon për një person të veçantë të dhënat e të cilit do të transmetohen, bazën ligjore për transmetimin e këtyre të dhënave dhe procedurat gjyqësore për të cilat nevojiten ato. Shteti dërgues refuzon transmetimin e të dhënave nëse kërkesa nuk përputhet me dispozitat e fjalisë së mësipërme.
- (8) Shteti pranues siguron që brenda një periudhe prej 5 vjetësh nga përfundimi i procedurave të referuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij Neni, është i mundur përcaktimi i të adresuarit, datës dhe qëllimit të transmetimit të të dhënave.
- (9) Shteti pranues parashikon në legjislacionin e tij vendor që të dhënat e dorëzuara përpunohen në mënyrë të ligjshme, në mënyrë proporcionale dhe në përputhje me qëllimet e referuara në paragrafin e parë, dhe përcakton masat dhe mënyrat e duhura të mbrojtjes së të dhënave personale.

## KAPITULLI DY DISPOZITAT E VEÇANTA

### Shërbimi i dokumenteve Neni 12

- (1) Përveç informatave nga Neni 5 i kësaj Marrëveshjeje, kërkesa për shërbimin e dokumenteve përmban adresën e personit të cilit i shërbehet dokumenti.
- (2) Autoriteti i kërkuar merr të gjitha masat e nevojshme për përcaktimin e adresës së duhur, nëse personi të cilit duhet t'i bëhet shërbimi nuk mund të gjendet në adresën e shënuar në kërkesë.
- (3) Shërbimi i dokumenteve vërtetohet nëpërmjet një certifikate të dorëzimit, e cila hartohet në bazë të rregullave të Shtetit të kërkuar. Certifikata e dorëzimit specifikon vendin dhe datën e pranimit dhe nënshkrimin e marrësit ose përcakton një metodë tjetër të dorëzimit.
- (4) Palët mund t'u dorëzojnë dokumente qytetarëve të tyre dhe të marrin deklarata nga ta nëpërmjet përfaqësuesve të tyre diplomatik, pa përdorimin e masave shtrënguese.
- (5) Fletëthirrja për një të pandehur, dëshmitar, dëshmitar ekspert apo pjesëmarrës tjetër në procedurë penale i cili ftohet nga Shteti i kërkuar nuk përfshin kanosje të një mase shtrënguese në rast se ata nuk i përgjigjen fletëthirrjes. Nëse personi i thirrur nuk i përgjigjet ftesës, ai nuk do t'i nënshtrohet asnjë dënimi.

### Dorëzimi i përkohshëm i personit të privuar nga liria Neni 13

- (1) Nëse Pala që kryen procedurat penale fton për qëllim të një seance dëgjimore, në cilësinë e dëshmitarit ose dëshmitarit ekspert apo për ballafaqim, një person i cili është privuar nga liria në Palën tjetër, ai mund t'i dorëzohet përkohësisht Shtetit kërkuar.
- (2) Shteti kërkuar e kthen personin përkohësisht të dorëzuar brenda afatit të përcaktuar nga Shteti i kërkuar.
- (3) Dorëzimi i përkohshëm refuzohet nëse:
  - 1) personi i privuar nga liria nuk pajtohet me dorëzimin e përkohshëm;
  - 2) dorëzimi i përkohshëm mund të shkaktojë vazhdimin e periudhës së privimit nga liria;
  - 3) ka arsye të tjera të rëndësishme kundër dorëzimit të tyre të përkohshëm në Shtetin kërkuar.
- (4) Dorëzimi i përkohshëm mund të shtyhet nëse prania e personit të privuar nga liria është e nevojshme në procedurat penale që kryhen në territorin e Shtetit të kërkuar.
- (5) Nëse një vend i tretë duhet t'i dorëzojë personin e privuar nga liria njëherë nga Palët përmes territorit të Palës tjetër, Pala tjetër, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, mund të lejojë sipas kërkesës së shoqëruar me të gjitha dokumentet e nevojshme, transitin e personit të privuar nga liria, nëse ai nuk është qytetar i asaj Pale.
- (6) Në rastin e referuar në paragrafin 5 të këtij Neni, personi i dorëzuar mbahet në paraburgim në territorin e Palës përmes së cilës kërkohet transiti, përveç kur Pala nga e cila kërkohet transferimi kërkon lirimin e tij.
- (7) Nëse Shteti i kërkuar vepron në bazë të kërkesës, Shteti kërkuar mban personin e privuar nga liria në ndalim gjatë qëndrimit në territorin e tij dhe e kthen atë menjëherë në Shtetin e Kërkuar pas ofrimit të ndihmës juridike, nëse Shteti i kërkuar nuk kërkon lirimin e tij. Personi i dorëzuar gëzon mbrojtjen e parashikuar në Nenin 15 të kësaj Marrëveshjeje.
- (8) Autoritetet kompetente të Palëve dorëzojnë personat e referuar në paragrafin 1 të këtij Neni dhe bien dakord për vendin dhe datën e dorëzimit.

**Kontrolli, Sekuestrimi dhe Konfiskimi i sendeve dhe të ardhurave**  
**Neni 14**

- (1) Palët i mundësojnë njëra-tjetrës, sipas kërkesës, ndihmën më të gjerë të mundshme në identifikimin dhe gjurmimin e sendeve, të ardhurave dhe pasurisë që i nënshtrohen konfiskimit.
- (2) Pasi të jenë gjurmuar të ardhurat nga krimi ose sendet që lidhen me veprën penale, në pajtim me paragrafin 1 të këtij Neni, Shteti i kërkuar, me kërkesë të Shtetit kërkues, miraton çfarëdo mase të përcaktuar në legjislacionin e tij vendor, me qëllim të ngrirjes dhe konfiskimit të këtyre të ardhurave nga krimi ose sendeve që lidhen me veprën penale.
- (3) Pasuria e konfiskuar nga Shteti i kërkuar në përputhje me paragrafin e mësipërm të këtij Neni trajtohet nga ai shtet në përputhje me legjislacionin e tij vendor.
- (4) Kur veprohet sipas kërkesës së bërë nga Shteti kërkues në përputhje me paragrafin 3 të këtij Neni, Shteti i kërkuar, deri në masën e lejuar nga legjislacioni vendor dhe, nëse kjo kërkohet nga Shteti kërkues, i jep prioritet kthimit të pasurisë së konfiskuar në Shtetin kërkues në mënyrë që ky të mund të jap kompensim për viktimat e krimit ose t'ua kthejë këtë pasuri pronarëve të ligjshëm.
- (5) Palët i mundësojnë njëra-tjetrës, sipas kërkesës, ndihmën më të gjerë të mundshme sipas legjislacionit të tyre vendor në ekzekutimin e masave ekuivalente me konfiskimin që çojnë në privimin nga pasuria, të cilat nuk janë dënime penale, për aq sa këto masa urdhërohen nga një autoritet gjyqësor i Shtetit kërkues në lidhje me një vepër penale, me kusht që të jetë konstatuar se pasuria përbëhet nga të ardhura nga krimi.

**Mbrojtja e dëshmitarëve, dëshmitarëve ekspertë dhe të pandehurve**  
**Neni 15**

- (1) Dëshmitari ose eksperti, pavarësisht nga shtetësia e tyre, duke iu përgjigjur ftesës para autoriteteve gjyqësore të Shtetit kërkues, nuk ndiqet penalisht, paraburgoset apo nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë së tij personale në territorin e asaj Pale në lidhje me veprat penale të kryera para mbërritjes së tij në territorin e Shtetit kërkues.
- (2) Një person, pavarësisht nga shtetësia e tij, i ftuar para autoriteteve gjyqësore të Shtetit kërkues për t'u përgjigjur për vepra që përbëjnë objektin e procedurës ndaj tij, nuk ndiqet penalisht, paraburgoset apo nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë së tij personale për veprat penale apo dënimet para nisjes së tij nga territori i Shtetit të kërkuar dhe të cilat nuk janë specifikuar në fletëthirrje.
- (3) Imuniteti i parashikuar në këtë Nen hiqet nëse dëshmitari ose eksperti ose personi që ndiqet penalisht, pasi e ka pasur mundësinë për t'u larguar, në një periudhë prej 15 ditëve të njëpasnjëshme nga data kur prania e tij më nuk kërkohet nga autoritetet gjyqësore, ka mbetur megjithatë në territorin e Shtetit kërkues, ose pasi që është larguar, është kthyer përsëri.

**Njësitë e përbashkëta të hetimeve**  
**Neni 16**

Nëse rrethanat e rastit e justifikojnë atë, njësitë e përbashkëta të hetimeve mund të krijohen me anë të një marrëveshje të përbashkët midis autoriteteve kompetente të Palëve.



### Njoftimet nga dosjet penale Neni 17

- (1) Palët informojnë njëra-tjetrën për të gjitha dënimet e qytetarëve të Palës tjetër, të cilët janë të regjistruar në dosjet e tyre penale. Palët dorëzojnë këto të dhëna çdo 6 muaj nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Sllovenisë, gjegjësisht.
- (2) Palët mund të informojnë njëra-tjetrën edhe për të dhëna tjera të përfshira në dosje penale.
- (3) Autoriteti kompetent për menaxhimin e dosjeve penale të njëjës Palë, sipas kërkesës do t'i dorëzojë një kopje të dosjes penale autoritetit gjyqësor kompetent të Palës tjetër para të cilit janë duke u zhvilluar procedurat penale.

### Informacioni mbi legjislacionin Neni 18

Palët informojnë njëra-tjetrën, në bazë të kërkesës, mbi legjislacionin në fuqi ose që ishte në fuqi në territorin e vendeve të tyre dhe, nëse është e nevojshme, dërgojnë tekstet e këtyre rregulloreve, si dhe njoftimet për çështje të caktuara ligjore në lidhje me çështjen që është subjekt i kësaj Marrëveshjeje.

### Shkëmbimi spontan i informatave Neni 19

- (1) Pa cenuar hetimet ose procedurat e tyre hetimore, pa kërkesë të mëparshme, Palët mund t'i dorëzojnë njëra-tjetrës të dhënat që ato kanë fituar mbi veprat penale dhe kryesit e tyre, nëse ato konsiderojnë se këto të dhëna mund të përdoren për të filluar ose kryer procedura penale ose mund të çojnë në dërgimin tutje të një kërkesë sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.
- (2) Shteti dërgues, në përputhje me legjislacionin vendor, mund të vendosë kushte për përdorimin e një informacioni të tillë nga ana e Shtetit pranues.
- (3) Shteti pranues i nënshtrohet këtyre kushteve.

### Transferimi i procedurës penale Neni 20

- (1) Nëse shtetasi i njëjës Palë ose cilido person që ka vendbanim të përhershëm në territorin e saj kryen një vepër në territorin e Palës tjetër, e cila është një vepër penale në të dyja Palët, Pala në të cilën është kryer vepra penale mund t'i kërkojë Palës tjetër të marrë përsipër procedurën penale.
- (2) Në lidhje me kërkesat për transferimin e procedurës penale, autoritetet kompetente të Shtetit kërkues marrin të gjitha hapat e nevojshëm për t'i mundësuar Shtetit të kërkuar kryerjen e procedurave penale. Kjo përfshin dorëzimin e një personi të mbajtur në paraburgim në Shtetin kërkues te autoritetet e Shtetit të kërkuar, nëse ky person nuk është shtetas i Shtetit kërkues.
- (3) Nëse një person në Shtetin Kërkues mbahet në ndalim, autoriteti kompetent i Shtetit të kërkuar informon Shtetin kërkues për vendimin e tij sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe jo më vonë se 30 ditë.
- (4) Autoritetet kompetente të Shtetit të kërkuar kryejnë procedurat penale, në përputhje me legjislacionin e tyre vendor.

**Përmbajtja e kërkesës për transferimin e procedurave penale**  
**Neni 21**

- (1) Kërkesa për marrjen përsipër të procedurës penale përshkruan faktet e rastit dhe tregon të dhënat sa më të plota që është e mundur për të pandehurin, shtetësinë dhe vendbanimin e tij të përhershëm apo të përkohshëm.
- (2) Kërkesës do t'i bashkëngjiten si në vijim:
1. dosjet origjinale ose kopjet e tyre të verifikuara;
  2. nëse është e mundur vërtetimi i nënshtetësisë ose vendbanimit të përhershëm të personit marrja përsipër e ndjekjes penale e të cilit kërkohet;
  3. ekstrakti i dispozitave të ligjit penal në fuqi në Shtetin kërkues në lidhje me atë çështje penale;
  4. deklaratat e palëve të dëmtuara, nëse është e zbatueshme;
  5. provat, nëse ka.
- (3) Deklarata e palës së dëmtuar, e cila është e nevojshme për të filluar procedurat penale në Shtetin kërkues, ka efekt ligjor edhe në Shtetin e kërkuar.
- (4) Nëse Shteti i kërkuar nuk pranon kërkesën për marrjen përsipër të procedurës penale, ai njofton Shtetin kërkues, duke deklaruar arsyet për refuzimin dhe kthen dosjet dhe provat të cilat janë dorëzuar me kërkesën.

**Efektet e transferimit të procedurave penale në Shtetin kërkues**  
**Neni 22**

Autoritetet gjyqësore të Shtetit kërkues, heqin dorë përkohësisht nga masat e ndjekjes për veprat e listuara në kërkesën për marrjen përsipër të procedurave penale. Nga masa të tilla duhet në çdo rast të hiqet dorë nëse:

1. gjykata e juridiksionit kompetent ose autoriteti kompetent i Shtetit të kërkuar ka ndërprerë procedurat penale me fuqi dhe efekt të formës së prerë për shkak të mungesës së provave ose për shkak se vepra e kryer nuk është vepër penale;
2. i pandehuri është shpallur i pafajshëm deri në një vendim me fuqi dhe efekt të formës së prerë në Shtetin e kërkuar;
3. dënimi i cili është miratuar në Shtetin e kërkuar tashmë është zbatuar, ose nëse zbatimi nuk mund të kryhet në bazë të ligjit apo për shkak të një faljeje apo amnistie, ose nëse është e ndaluar për shkak të parashkrimit sipas ligjit të Shtetit të kërkuar.

**Njoftimi mbi vendimin në lidhje me transferimin e procedurave penale**  
**Neni 23**

Shteti i kërkuar njofton shtetin kërkues për rezultatin e procedurave penale në lidhje me kërkesën për marrjen përsipër të procedurës penale, dhe për këtë qëllim dorëzon origjinalin ose transkriptin e vërtetuar të vendimit që ka fuqi dhe efekt të formës së prerë.

**KAPITULLI TRE**  
**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**  
**Neni 24**


Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë zbatimit ose interpretimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet konsultimeve ndërmjet autoriteteve kompetente ose nëpërmjet kanaleve diplomatike.

**Hyrja në fuqi, amendamenti dhe ndërprerja**  
**Neni 25**


- (1) Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit vijues pas datës së marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet të cilit Palët njoftojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike se kanë përfunduar procedurat e tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.
- (2) Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohore. Secila Palë mund ta ndërpresë Marrëveshjen përmes njoftimit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike. Marrëveshja skadon 6 muaj pas marrjes së këtij njoftimi me shkrim për ndërprerje.
- (3) Kjo Marrëveshje mund të amendamentohet në çdo kohë me marrëveshje me shkrim ndërmjet Palëve. Çdo amendamentim i tillë hyn në fuqi në përputhje me procedurën e parashikuar në paragrafin 1 të këtij Neni.

E nënshkruar në SLOVENI më 28.10.2016 në dy kopje origjinale, në gjuhët shqipe, serbe, sllovene dhe angleze, të gjitha tekstet njësoj autentike. Në rast të mospërputhjeve në interpretim, do të mbizotërojë teksti në gjuhën angleze.

PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS

  
Dhurata Hoxha  
Ministre e Drejtësisë

PËR REPUBLIKËN E SLLOVENISË

  
mag. Goran Klemencič  
Ministër i Drejtësisë